



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot. 01-592/16
Br. Prot. 01-592/16
Prot. No. 01-592/16
Data 12-02-2016
Datum 12-02-2016
Nr. Ifaq. 02
Broj. stranica 02



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.02.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-3286/15, për znj. Fëllënëza Xhelili Fiqi – Anëtare e Bordit në Ndërmarrjen Publike “Infrakos” sh.a., për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për znj. Fëllënëza Xhelili Fiqi – Anëtare e Bordit në Ndërmarrjen Publike “Infrakos” sh.a., me nr. AKK – 03-02-3286/15, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji PKI).

Rasti është hapur bazuar në informacionet e Divizionit për Deklarimin e Pasurisë, sipas të cilave znj. Xhelili Fiqi, krahas funksionit të zyrtares së lartë (Anëtare e Bordit), ushtron edhe funksionin e Menaxheres së Sektorit të Tarifave në Ndërmarrjen Publike “KOSTT” sh.a.

Bazuar në këto informacione zyrtarët e AKK-së kanë organizuar takim me zyrtaren e lartë e cila ka deklaruar se në Ndërmarrjen KOSTT nuk ushtron funksion menaxhues – vendimmarrës. Për të vërtetuar këtë ajo ka ofruar edhe organogramin e Ndërmarrjes KOSTT dhe shkresën për përshkrimin e detyrave të punës. Në bazë të këtyre shkresave shihet se funksioni i znj. Xhelili Fiqi, nuk hyn në kategorinë e funksioneve menaxheriale.

Bazuar në këto të dhëna, ushtrimi i funksioneve të lartpërmendura nuk i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në nenin 15 (pika 2) të Ligjit PKI.

Andaj, bazuar në nenin 18 (pika 10) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, duke marrë parasysh të gjitha faktet që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, vlerësojmë se nuk ka konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

